

**Robert Prennushi**

## **VEPRA E ÇESK ZADEJËS DHE KOHA KUR JETOI**

(Mendime për veprën e akademikut, Prof. Dr. Vasil S. Tole 'ÇESK ZADEJA NË MUZIKËN SHQIPTARE'-Jeta dhe vepra)

Nuk ndodh shpesh me pasë në dorë një vepër të tillë. Figura e Çesk Zadejës, edhe pse e njihnim edhe personalisht si vëllai i shokut e mikut tonë, Tonin Zadeja, kishte një vel misteri që të impononte respekt edhe pse nuk krijonte disatancë; përkundrazi ishte edhe i përzemërt.

Përveç interesit me dijtë ma shumë për një figurë madhore të muzikës sonë, nuk ishte ma i vogël edhe kurjoziteti me kuptue nga leximi i kësaj vepre me mbi 700 faqe, edhe se si Zadeja, me atë biografi që kishte - të cilën do ta shohim jo vetëm në një variant- kishte arrijtë të bahej *factotum* në muzikën shqiptare - e gati-gati edhe si zadhanës i qendrimit zyrtar për problemet e muzikës. Nga ku i vinte ai autoritet? (Edhe pse vlerën ja njihnim të gjithë).

Vinte rallë në Shkodër, por për Çeskun dihej e flitej. Flitej për veprat e jo vetëm. Edhe diskutohej: 'Çesku apo Prenka', si dikur në Itali 'Verdi apo Wagner'. Madje kishte zane që thonin 'Çesku kundër Prenkës'!? E pra të gjithë e dinin se Çesku i gjendej në nevojë çdo shkodrani e jo vetëm.

Kurreshtje krijonte edhe dëshira me kuptue se si kishte arrijtë Zadeja ta ruejë krijimtarinë e tij kaq pak të politizueme. Asht fati e squetësia e tij dhe fati yni që e kemi pothuaj të plotë atë. Natyrisht ndonjiherë u detyruet të paguej dhe haraçin e metodës së realizmit socialist, por për mënjanimin nga trajtimi i temave të mëdha, ai përdorte 'mburojen': *Unë jam nip i Dom Ndre Zadejës*; si me thanë se nuk i takonte atij, me atë biografi, me shkruet për këte e o atë temë politikisht të randësishme.

Kujtoja se dija shumë për Zadejen mbasi kisha ndjekë, të pakten që nga viti 1952, të gjitha zhvillimet muzikore, e jo vetëm, në vendin tonë...

Por u binda – e do të binden edhe lexuesit - se profesor Tole, tue qenë kompozitor, muzikolog; tue qenë sidomos shumë kërkues e gjithnji dashamirës, ka dijtë të na japë me detaje Çesk Zadejen jo vetëm si kompozitor, por edhe si njeri; në marrëdhانيت zyrtare e private, madje dhe në jetën e vet personale jo të sheshët. Lokalizimi historik i personazhit asht i plotë, ku koha, ambjenti, ngjarjet janë të gërshetueme, ndonjiherë edhe si në një vepër letrare, gja që shton dhe interesin për lexim.

Faktet e mbështetuna në një dokumentacion shumë të pasun, të habisin. Por autori Tole tue shfytëzue mendimin kritik te kohës, zgjedh kryesisht mënyrën 'korale' për të nxjerrë konkluzione, madje tue shfytëzue mendimet edhe të ish nxanësve të Zadejës e kështu, edhe kur jep mendime e kokluzione personale si 'i barabartë në mes të

barabartëve', ata vijnë natyrshëm, gja që ja shton vlerën vepres dhe shton vemendjen e lexuesit, tue e nxitë edhe atë të japë mendimin e vet. Si do të veprojmë edhe ne ndonjiherë.

Por janë tre rreshta që autori Tole i ve në Hyrje, si për të thanë: 'ju ndigjoj të gjithëve, por këtu nuk los'. Pra, si për të evitue çdo dyshim, autori e fillon librin me këto fjalë:

*Ky libër i kushtohet Çesk Zadejës, kompozitorit dhe personalitetit më të rëndësishëm të muzikës shqiptare, pa rolin, veprimtarinë e krijimtarinë e të cilit nuk mund të kuptohet muzika profesioniste shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX, e më pas.<sup>1)</sup>*

Dhe i gjithë libri duket se asht shkruar për të vertetue këte tezë; por askush nuk kujtohet, sepse libri, si ndërtim, me digresionet e veta, tue trajtue vepra, probleme e ngjarje, -në dukje edhe 'jo muzikore'- bahet edhe një histori e muzikës shqiptare, sidomos për gjysën e dytë të shek. XX.

Vepra, me referencat, bibliografinë e aparatit shkencor të pasun, (me redaktor Redaktor shkencor Kujtim Shkreli), bahet edhe një burim njohje për muzikantët e rij, të cilët mund të gjejnë tituj veprash e probleme që mund t'u interesojnë, pra jo vetëm për kompozitorin Çesk Zadeja.

Nuk di sa në shkrimin tim do të mund të riej një farë uniteti, sepse autori i veprës me të drejtë ndjek edhe kriterin historik edhe atë tematik, e kjo sjell dhe digresione, që në një vepër madhore si kjo janë të domosdoshme.

## **Fenomeni muzikor Zadeja**

Kushtet shkodrane se kur e si lindi fenomeni muzikor Zadeja e të tjerë bashkëmoshatarë të tij, trajtohet gjanësisht me referenca të pasuna edhe nga ana historike. Autori mendon se vetëm tue spjegue mirë këte shtrat historik e muzikor të Shkodrës, mund të kuptohet edhe fenomeni Zadeja; mund të spjegohet si lindi një talent i tillë, dhe të tjerë si Jakova, Daija, Harapi etj.

Këte hetim të vemendshëm historik, autori e fillon me një hipotezë, që edhe ne e kemi ndeshë në disa lutje të lashta, kur thotë: *Mund të mendohet se P. Budi i përcillte edhe vargjet e veta në sfondin e melodive vendëse.*<sup>2)</sup> Por ajo që analizohet me të drejtë ma shumë, asht përjudha afër Lidhjes së Prizrendit deri tek fillimi i Luftës së Dytë; tue vazhdue dhe pak vite mbas saj.

Natyrisht flitet ma shumë mbi përpjekjet për zhvillimin e muzikës së kultivue, për përkursorët e shquem Palokë Kurti, Frano Ndoja e Martin Gjoka. Shumë të dhana janë marrë nga 'Jeta kulturore e Shkodrës',<sup>3)</sup> vepër serioze e muzikologut Tonin Zadeja - studjuesi serioz e modest, që vëllai i tij 'i vogël', Çesku, pa dashtë e la pak në hije.

Por autori Tole asht edhe 'me fat' pse ka në dorë - e pjesërisht i citon - dy *jetëshkrime* të Çesk Zadejës. I pari asht një fletë e vetme me shkrim dore, që përfundon me fjalinë *në*

vitin 1949/51 kam punuar pranë Ansambllit Artistik të Ushtrisë. Të ban përshtypje që Zadeja përdor gjithnji pjesorën toske: 'lindur, kryer, vazhduar', ndërsa kur i shkruen R. Alisë më 1963, i shkruen gegnisht... Mos asht ky një bocet *jetëshkrimi a biografie*, si ta quejmë, që ja ka kërkue ndonji dashamirës, për të ba që të pranohet me vazhdue studimet jashtë? Tole na ban me kuptue se falë dashamirësisë së Gaço Avrazit, Çesku arriti të studjonte jashtë. Tjetra autobiografi, si duket asht shkruet mbas daljes në pension, ndoshta atëherë kur jetëshkrimi mund të shkruet ashtu si ishte? Për historinë e autobiografive të Zadejës, autori Tole, na le të kuptojmë shumë. E pa dashje na shkon mendja tek vepra e rusit Solomon Volkov 'Stalin e Shostakoviç' - me nëntitullin 'Marrëdhania e pazakontë mes diktatorit të egër me muzikantin e madh'.

Në lidhje me formimin e Çeskut, që në fëmëni, flet vetë ai, kur kujton rolin që ka luejtë i ati, Rrok Zadeja, rrobaqepës me profesion, por artist i lindun i skenës dhe pjestar i bandës muzikore.

*...që të vogël më merrte me vehte si në provat e shfaqjeve teatrale, ashtu dhe në koncertet që jepte banda. Këto takime padyshim lanë gjurmët e veta të para mbasi aty unë u njoftova me mjaft vepra të autorëve tanë, si Palokë Kurti, Frano Ndoja, Martin Gjoka, etj. Shkollën fillore kam bërë në shkollën 'Skenderbej' dhe ate '28 Nentor'. Liceun pjesërisht në 'Illyricum'(Shkolla e Françeskaneve) dhe Liceu i Shtetit. [Ishte koha kur françeskanëve e jo vetëm u mbylleshin shkollat, nga Zogu dhe pushtuesi RP] Në shkollën fillore jam aktivizuar në korin e fëmijëve të shkollës, ku jam njohur për herë të parë me vepra të autorëve botërorë, si Bach, Hendel, Schubert etj. Në këte kohë kam marrë dhe përshtypjet e para të muzikës. Në këte përvujdhë vazhdimisht kam ndjekur jeten koncertale të qytetit, si koncertet që jepnin bandat, posaçrisht e bashkisë, të cilën e drejtonte Zef Kurti e koncertet modeste të Shoqërisë Rozafat (f.25) [Për të mos randue bibliografinë, citimet nga vepra e Toles do të kenë të shenueme vetëm nr. e faqes.R.P.]*

Asht me interes fakti që studjuesi Tole, e quen të nevojshëm t'i kushtojë një kapitull, atë të dytin, rolit të françeskanëve. Tek 'Francheskanët dhe muzika e Figura e (At) Martin Gjokës' studiuesi spjeron si mundi të lindë një fenomen i tillë si Zadeja dhe tek Gjoka ai sheh fillimin e muzikës profesioniste, por edhe *akordin e parë atonal*, që spjeron në një farë mënyre se Gjoka njihet edhe vepra ma të avancueme se ato që shkruente ai vetë, por niveli i ndigjuesit të asaj kohe ja impononte këte thjeshtësi. E tue u thellue në shkrimet për Gjokën, zbulon në një studim atë që *faktikisht shenjon akordin e parë politonal të muzikës sonë: Në masen e tetë të Pastorales në fjalë, At Martin Gjoka mbivendosë në një akord të vetëm subdominantën Reb mazhor, (në dorën e majtë në bas në formë pedali, në formën Lab- Reb në kuintë), dhe akordin e dominantës Mib minor, (në melodinë e dorës së djathtë, përmes akordit pa tercë në formën e Mib-Sib, po në kuintë)*. (f 62)

Në *autobiografinë* me shkrim dore, Zadeja tregon praktikisht se mësuesi i tij i parë, 'mjeshtri', ka qenë Prenkë Jakova. Këte pohim bajnë dhe Tish Daija, Tonin Harapi etj.

*Që në moshën fare të re, në Shkollën fillore kam qenë antar i korit të françeskanëve, kurse që në moshën 9 vjeç kam marrë pjesë në bandën e shoqërisë 'Antoniane' të drejtue me nga mjeshtri P. Jakova. .. Aty mësova muzikën, fillova të formoj bindjet e para , krijova shijen time posaçërisht nga krijimtaria e Prenkë Jakovës, i cili krijonte për këte bandë marshe, potpuri me kangë e valle popullore, gjithashtu egzekutonim dhe*

*pjesë të ndryshme nga literatura muzikore botërore. Aktiviteti i saj ishte pjesëmarrja në festa të ndryshme kombëtare, ashtu dhe të shkollës etj. (f. 54)*

Dhe ma vonë do të shkruente: *Prenkë Jakova ishte një kompozitor që i donte dhe besonte në vlerat e këngës popullore e patriotike. Krijimtaria e tij e deshmon këte. Por ai ishte dhe një propogandues i flaktë i këngës popullore. Jemi një brez shokësh që kemi provuar ndikimin e tij për njohjen dhe studimin e këngës popullore. Kompozitori Tish Daija, Simon Gjoni, Tonin Harapi, Tonin Rrota etj, morëm njohuritë e para prej tij në këte drejtim.<sup>4)</sup>*

Tue vazhdue studimin e shtratit historik ku u formue Zadeja në Shkodër, studjuesi Tole na jep një të dhanë që duket si statistikë, por që flet shumë: “Shkodra në vitin 1939 kishte 7 salla shfaqjesh muzikore e teatrore “; e i përmendë të gjitha tue tregue dhe kapacitetet me 350, deri 450 vendesh katër prej tyne.

Tue nënvizue rolin e kompozitorit At Martin Gjoka në formimin e Zadejës, autori Tole citon vetë Zadejën që e quen At Martinin: *Një nga figurat më të shquara të traditës muzikore shqiptare; në punën e tij të gjithanshme krijuese, organizuese, dhe drejtuese, ndikoi fuqishëm në përgatitjen dhe edukimin e një brezi të tërë muzikantësh.f.58* Dhe ne citojmë edhe dirigjentin E. Koço (shumë herë i cituem nga Prof. Tole), i cili asht edhe egzekutuesi i parë i Sinfonisë ‘Dy lule mbi vorr të Skanderbegut’: *At Martin Gjoka, mund të thueht me plot zë, është krijuesi i një gjuhe muzikore specifike shqiptare e cila rrezatoi tek mjaft kompozitorë shkodranë që, të gjithë e dimë, kanë qenë në pararojë të artit muzikor shqiptar.<sup>5)</sup>*

Për formimin e tij, Zadeja flet edhe për rolin e Dom Mikel Koliqit (ma vonë Kardinali i parë shqiptar) dhe të Dom Ndre Zadejës, poetit dhe dramaturgut.

Me një gjetje - krahasim vertetë befasues -Tole citon fratin poet:

*Ndjesitë e mia me valët muzikore*

*Shkëmbejnë puthje të nxehta*

*Porsi dy dashnorë”.*

E shton: *‘Euripidi kishte të drejtë kur lidhte njeriun e lumtur me qytetin e dëgjuar. Zadeja dhe Shkodra ishin një binom i tillë’.f.36*

Në koralitetin e mendimeve, autori Tole i jep za edhe At Zef Pellumbit:

*Ai [At M. Gjoka] kishte lanë mbas vetes disa dishepuj të dejë , ndër ta edhe Prenkë jakova e Çesk Zadeja, të cilët u mbështeten në vlerat e mëdha të muzikës së tij dhe zhvilluen në këte frymë muzikën kombëtare shqiptare, tue krijue ma vonë vepra madhore; por njifen gjithmonë si vepra të daluna nga shkolla e padër Martinin, mjeshtrit të madh të tyne.<sup>6)</sup>*

## **Studimet në Itali dhe fillimet mbas Luftës**

Në vitet 1941-1943 Çesk Zadeja ndjek studimet në Konservatorin ‘Santa Cecilia’. Në atë konservator ndiqnin mësimet edhe Prenkë Jakova, Ndoc Shllaku, ndërsa Gjon Kolë Kujxhija ndiqte studimet në Firenze. Edhe të tjerë studentë, për muzikë e jo vetëm, ndiqnin

studimet në ata vite në Itali. Se si arritën të fitojnë bursat, autori Tole jep edhe shpjegimet, madje edhe një si anekdotë për rastin e Çeskut.

Për Zadejën, por edhe për Jakovën ata pak vite në 'Santa Cecilia' luejtën një rol vendimtar për orjentimin që duhet të ndiqnin. Profesor Kolë Ashta, edhe ai student në atë kohë, kujton gëzimin për takimin me Kujxhinë, Zadejen dhe Jakovën, në një Bar të njohun në Romë. *Atë natë na u dukte vetja se ishim sunduesat e Qytetit të Amshuem. f.77*

Nga shkakut i bombardimeve në Romë në vitin 1943 edhe Zadeja kthehet në Shkodër. Në *Autobiografinë 'zyrtare'* Zadeja shkruen se i ati, rrobaqepës, punonte rroba për ata të malit, ndërsa vetë aktivizohet e merr pjesë e ngarkohet me detyra në grupet antifashiste. Tregon për një takim në vitin 1943 me Vasil Shanton. Gjendet në demonstratën e 28 nëntorit 1942, ku u vra Vasil Shanto, që le me kuptue se asht kthye nga Roma për këte qellim. Në vitin 1945 zgjidhet në Plenumin e Rinisë Antifashiste. Tregon edhe se si me shokë pastrojnë qelinë në ish Kuesturën, ku ishte ende gjaku i dëshmorit Manush Alimani.

Shkruen në autobiografinë Zadeja: *...më 1945, me krijimin e Radio Shkodrës, fillova punën si përgjegjës i muzikës.*

Si kemi thanë dhe ma nalt, autori Tole, që nuk le fakt e material pa demonstrue, kur e sheh se këto duhen interpretue, jep mendimin e vet që nuk mund të mos të terheqë vemendjen. Shkruen Tole:

*Në përfundim shkurt-mars 1945, kohë e cila përfshin arrestimin dhe pushkatimin e Dom Ndre Zadejës, Zadeja fillestar në kompozim, u ul dhe shkroi 'Melodi përkujtimore për V. Shanton'. Ne jemi tërësisht të bundur, vazhdon Tole, se ky krijim është në thelb edhe një dedikim i ndjerë muzikor i Zadejës për figurën e Don Ndre Zadejës. Në pamundësi që ta bënte këte gjë hapur dhe në liri të plotë, Zadeja zgjodhi me mençuri, që duke marrë shkas nga fakti publik i Një vjetorit të vdekjes së Vasil Shantos, të bënte njëherazi një krijim me dy qëllime: kujtimin e figurës së Vasil Shantos përmes fjalëve dhe vajtimit të Don Ndre Zadejës përmes melodisë funebre të cilën e ndërtoi mbi modelin e elegjive vajtuese fetare... sepse... figura e Don Ndre Zadejës ishte një shembëlltyrë e njeriut të dashur, shkrimtarit patriot e atdhedashës dhe ajo e klerikut dinjitoz" f. 86*

Puna në Radio Shkodra dhe në Shtëpi të Kulturës, njohja e bashkëpunimi me muzikantë e kompozitorë si P. Jakova, T. Daija, S. Gjoni L. Deda etj. orkestrimet e para e shoqimimet me pianofortë i solistëve File Gjeloshi, Klotilde Shantoja, Florinda Gjergji, por edhe egzekutimi i një repertori të gjanë siç e kerkonte një institucion si ishte Radioja, ishin laborator i parë në formimin e Zadejës si muzikant.

Tregon Zadeja: *krijimi i dytë asht kanga 'Doli nana në çardak', me porosi të Vehbi Balës. Këte këngë e këndoi kori i Shtëpisë së Kulturës, nën drejtimin e Prenkë Jakovës. Prenka kishte një cilësi të veçantë: këngët ai i interpretonte me një kujdes të veçantë. f.87* Edhe një rast tjetër i vlerësimit të Zadejës për Jakovën!

Në lidhje me temën "Zadeja për Jakovën" hapim edhe një parantezë. Shumë ma tej, në këte libër, do të hasim edhe një tjetër opinion të Zadejës më 1987, tek një monografi e muzikologut K.

Shkreli, ku shprehet kështu për Jakovën: *Artisti i Popullit, kompozitori Prenkë Jakova ka realizuar një pervojë të re me vlera për kulturën tonë muzikore shqiptare. Këngët, romancat, përpunimet e këngëve popullore e partizane, dy operat e tij, i percjellin historisë së muzikës sonë vlera të shquara dhe gjithnji aktuale.*

Mbas kapitujve të randësishëm, lexuesi ka mundësi edhe 'të pushojë', mbasi autori Tole na tregon shumë foto, mjaft prej të cilave botohen për herë të parë. Për punën e Zadejës në Radio 'Shkodra' shumë prej fotove i janë ofrue nga familja e kompozitorit Gjon Ndoc Shllaku.

Por vitet ma të randësishëm për formimin dhe krijimin e perspektivës të Zadejës për të ecë ma përpara, ishin vitet 1947-49 në Ansambin e Ushtrisë dhe fakti e fati që atë e drejtonte muzikanti i apasionuem e Njeriu i mirë, Gaqo Avrazi. Ishte ai që do ta ndihmonte Çeskun edhe për të studjue jashtë. Avrazi shkruen kështu për Çeskun: *ne i rrinim Çeskut në kokë. Ishim të bindur për talentin e tij dhe që ai mund të shkruante gjëra me shumë vlerë. Nuk i ndaheshim, duke provuar të gjitha format që ai të aktivizohej. Çesku na kuptoi dhe u mbyll në një dhomë. Aty hante dhe aty flinte. Nuk shkuan shumë ditë dhe Çesku krijoi dy 'Suitat e Veriut', korale të mrekullueshme që ishin punimet ma të mira të asaj kohe.f.94*

*Pavarësisht nga pozita e marëdhënieve ushtar- oficer, ai më donte shumë dhe me përkrahte për ato vepra modeste që shkruaja në atë kohë, do të shkruante Zadeja, për dirigjentin e talentuem G. Avrazi.*

Krijimtaria e Zadejës, tue pasë si laborator Ansambin, ngrihej cilësisht në vazhdim. Fakti që Kori i Ushtrisë jepte koncerte në të gjitha skajet e Shqipnisë, tue plotësue kështu dhe një nevojë shpirtnore të popullit që kishte dalë nga lufta, e njohu kompozitorin Ç, Zadeja edhe me folklorin e krahinave të ndryshme.

Për nivelin që po arrinte Zadeja, dirigjenti Mustafa Krantja më 1950 do të shprehej: *...Unë vija i kompletuar me studime profesionale, por për çudi, unë Çeskun e konsideroja një personalitet të komplementuar. (f.95)*

Me 29 Nandor 1949 niset në Bashkimin Sovjetik Ansambi i Ushtrisë dhe Çesk Zadeja asht në rolin e pianistit shoqnuet i solistëve dhe i korit. Ansambli pati sukses të madh e kjo eksperjencë i vlejti Zadejës edhe për të njoftë nivelet me të cilat duhen marrë si model.

Vjen dhe vlerësimi i parë zyrtar. Me 1950 dekorohet nga Kuvendi Popullor për 'Dolina në çardak' dhe për 'Suitat e Veriut'.

## **Në Moskë për studime**

Nga autobiografia e Zadejës: *Në mars të vitit 1951 shkova në Moskë për studime. Fillimisht u futa në shkollën ushtarake si dirigjent për bandë me që isha derguar si ushtarak....Në të vertetë mbasi më morën në provim më pelqyen shumë...Kerkova të studioja për kompozim si dirigjent për bandë... më propozuan të ma bëjnë të veçantë këte përgatitje me prof. V. Y. Shebalin*

(1902-1963), kompozitor i shquar dhe pedagog shumë i njohun, ish drejtor i konservatorit "Çajkovski".f.123

Mbas insistimit të tij, tregon Zadeja, arriti të futet në provimin për të hy në Konservatorin 'Çajkovski'. Komisioni ishte mbledhë me marrë në provim kursin e 5-të. E tregon se në komision ishte Shostakoviç, Kaçaturian, Kabalevskij e shumë të tjerë. Në shtator të vitit 1951 fillon mësimet në atë konservator për të cilin do të shkruente: *fat të madh dhe të paharrueshëm që kam kryer studimet në këte konservator me një autoritet botëror*.f.124 Nësa Tole na ban të njohun edhe atmosferën e nderë që egzistonte ndër kompozitorët sovjetikë si rezultat i platformës së Zhdanovit, atmosferë që do ta provonim edhe ne ma vonë në Shqipëri.

Në atë kohë studionte në Moskë ajka e muzikantëve e kangëtarëve, balerinë e koreografë shqiptarë, që do të banin ma vonë emën në vendin tonë. Ndër to dhe shoku i shkollës dhe i lagjes, Tish Daija.

E përsëri, për të ba aktualizimin historik por edhe politik të përbudhës që trajton, autori Tole tregon për kerkesat e E. Hoxhës ndaj Stalinit për të sjellë në Shqipëri 20 instruktorë. Në libër gjejmë listën e gjithë studentëve që studionin në ata vite në B.S. Nuk mungojnë edhe batutat gazmore për vendlindjen e Gj. Athanas, *Boston, Të R. Teqes Peqin-Pekin*. A. Mulës, Kosovë dhe habinë *Sot nuk paska qenë dita e Shqipërisë, por e tre kontinenteve*, që paska thanë sekretari.

Ndoshta për të kuptue se sa serjozisht dhe me çfarë qendrimi serioz Zadeja dhe Daija i kishin marrë studimet, Tole zgjedh këte shprehje të referueme nga muzikologu S. Kalemi, thanë nga vetë Zadeja:

*Unë dhe shoku im Tish Daija, kur përfunduem ciklin dy vjeçar për polifoninë e harmoninë, morëm vesht se kishim fituar vetëm një lloj ideje për këto lëndë me kaq rëndësi. Atëherë vendosëm t'i futeshim për herë të dytë nga fillimi atyre lëndëve . E në fakt, gjatë studimeve Zadeja shkroi disa fuga.*

Në vitin e dytë të konservatorit, më 1952, Zadeja asht në klasën e profesor M. I. Çullaki, kur mbi tekstin e Ll. Siliqit, shkruen romancën për bas e orkestër 'O ju male!'. Kjo romancë vlerësohet edhe si krijimi që konsolidoi epikën në këte gjini. Tole citon 'Historinë e muzikës shqiptarë': *...me figurën e maleve simbolizohet madhështia dhe pathyeshmeria e atdheut, se kjo përmbajtje e thellë epike për të parën herë depërton në melodinë dhe intonacionet muzikore në formën e një meditimi epiko-heroik..<sup>7)</sup>*

Zadeja asht student i zellshëm, por edhe prodhimtar. Krijimtaria tij pasunohet në formë e gjini, si 'Variacione për violinë solo', Muzika e filmit dokumentar 'Shqipëria' (1952), muzika e filmit 'Skenderbeu' (1952-53) dhe 'Tokata' (1954), pjesë për të cilën shkruen edhe revista 'Sovjetskaja muzika' . E vitit 1954 asht dhe vepra 'Variacione për piano' mbi temën kryesore të filmit 'Skenderbeu'. [Temë e gjetun dhe e përpunue me për

kor nga kompozitori At Martin Gjoka, por e shfrytëzuar nga shumë kompozitorë, ndër ta dhe nga vetë kompozitori V. S. Tole në operen 'Skenderbeu kryezot', 2020].

Se sa e vlerësonte Zadeja muzikën popullore, tregon edhe fakti se ai më 1953 boton 'Kangë Popullore shqiptare' dhe më 1955 'Kangë të Shqipërisë së re' së bashku me Tish Daija, me një parathanie të Martinovit. Zadeja fillon të krijojë kështu një fizionomi shumëplanëshe, pra jo vetëm si kompozitor.

Me përpunimet e disa kangëve popullore shqiptare e ruse dhe 'Simfoninë nr. 1' mbyllet krijimet e Zadejës në Moskë. Tole publikon edhe pjesë partiturash, madje dhe linkun për të ndigjue 'Tokatën'. Në libër edhe këte herë, përveç fotove të shumta, ka dhe një faximile të koncertit në shqip e rusisht, të dhanë nga studentët shqiptarë me 27 nandor 1954, me rastin e 10 vjetorit të Çlirimit në Sallën 'P. I. Çajkovski'. Asht një program serjuz me pjesë klasike e shqiptare, ku debutuen edhe A. Mula, I. Tukiqi, L. Kaçaj dhe Zadeja si kompozitor.

Tue përfundue përrjudhën e studimeve në Moskë, duem të theksojmë një fakt që Tole e përmend diku; një fakt a koençidencë, pra rastësi, por që do të ketë ndikim jo të vogël, në 'sigurinë' nga të papriturat e jetës e të politikës, për Zadejën; faktin që në atë kohë në Moskë studjonte edhe Ramiz Alija, 'delfini i të madhit', që pati rastin të marrë njoftime direkt edhe nga rusët për vlerat e Zadejës.

x x x

Do të ishte e pamundur të përmbliidhen, qoftë edhe në një shkrim të zgjanuem, analizat për veprat madhore të Zadejës që trajtohen në mënyrë korale nga stujuesi Tole. Këte dëshirë lexuesit mund ta gjejë vetëm në libër.

Për muzikën e filmit 'Skenderbeu' Sviridov-Zadeja, mësojmë se në fillim i ishte ngarkue kompozitorit Kristo Kono, i cili paskësh heqë dorë për arsye se shkuemja në Moskë do t'i damtonte shëndetin, ashtu si i kishte ndodhë në Paris gjatë studimeve në vitet -30-të. f151

Tole citon dirigjentin Eno Koço: *Zadeja dhe Sviridov përbënë një binom të shkelqyer në krijimin e muzikës së filmit Skenderbeu; i pari përzgjedhi të gjitha temat kryesore muzikore të filmit duke i adaptuar, transformuar apo krijuar mbi motive tradicionale shqiptare, ndërsa i dyti, si mjeshtër i orkestracionit dhe zhvillimit tematik, ishte ai që krijoi strukturën muzikore të muzikës së filmit.*f.153 [Ndër temat bashkë me motivin e At Gjokës 'Kenkan mbushun malet me borë' edhe *vallen* 'Drandofillja e bardhë'<sup>8)</sup>, si motivi i dashunisë së Mamicës me Palin, që Zadeja do ta shfrytëzojë dhe si temë në kohën e parë të Simfomisë së tij.R.P]

Nga mendimet për muzikën e filmit në fjalë, Tole citon edhe T. Harapin: *Ajo muzikë e shkruar në vitin 1953 nga Çesku ka një frymëzim të madh dhe një emocion të thellë. Ajo muzikë, mendoj se shenon apogjetë e para të tiparit të muzikës së Zadejës.*



Me 5 mars 1953, vdiq Stalini. Por vetëm 15 minuta ma parë kishte vdekë edhe kompozitori i shumë përfolun nga stalinistët, Prokofiev; kompozitori ma i madh i kohës, simbas Stravinskij. Për këtë qarkulloi shprehja se *Prokofievi ishte viktimi e fundit e Stalinit*. Revista 'Sovjetskaja muzika' e dha lajmin e vdekjes së kompozitorit vetëm në f. 118 të saj. Por në marrëdhëniet e vështira mes dikatorëve dhe artistëve flitet dhe për një farë porosie të Stalinit: *Shostakoviç, Esenshtejn, Pasternak, Eremburg, të mos preken*.f.168

Dhe Tole gjen rastin të përshkruaj atmosferën që ndjehej në atë kohë, ku idologët pro Zhdanovit ishin kundër çdo modernizimi në gjuhën muzikore, ndërsa në qarqet e përparueme të artit, ndër ta edhe Pasternak e quenin Stalinin *malok, xhuxh* etj. Natyrisht edhe dodekafonia përmendej nën za. Probleme e atmosferë që do të ndjehet ma vonë edhe tek ne e që pasqyrohen kaq mirë në këtë libër.

Dokumentimi deri në hollësi, asht një cilësi e veprës, gja që zgjon edhe interes. Autori Tole madje shenon edhe shtesën e diplomës me nr. 659097, ku pasqyrohen edhe provimet që ka dhënë Zadeja... ku thohet se *studenti Çesk Zadeja ka realizue diplomën me temë:*

- 1) *Simfonia me katër kohë për orkestër simfonike,*
- 2) *Kantata, 'Shqipëria-atdheu im', për solist, kor dhe orkestër*
- 3) *Këngë.*

### **Kthimi në atdhe**

#### **dhe Krijimi i Ansambilit Kombëtar të Kangëve dhe Valleve më 1957 asht një tjetër kapitull me randësi i librit**

Në maj të viti 1957, në një takim me shkrimtarë e artistë, E. Hoxha i shoqnuem nga R. Alia e tre antarë të tjerë Byrose Politike takohet me një grup shkrimtarësh e artistësh dhe thot: *Po ju tani, ç'po bëni? Ja tani, porsa ka ardhur Çesku, është plot energji të reja...*f.197

Me siguri këto të dhana ia kishte nga R. Alija, që supuzohet se në Moskë ishte informue për aftësitë e Zadejës. Injoranca e plotë e udhëheqjes për muzikën, si arti ma abstrakt, i bante që t'i shikonin artistët, sidomos kompozitorët, si të veçantë. Dhe në fakt, vetëm në sektorin e muzikës ndodhën çudina si për Prenkë Jakovën, që e nxorën nga burgu për të përgatitë përvjetorin e parë të Çlirimit. Por mbyllën një sy edhe në rastin e Zadejës.

Tek binomi 'Përmbajtja socialiste e forma kombëtare', udhëheqja ndjehej e sigurtë për elementin e dytë, pra për formën kombëtare, që Zadeja e mbronte me bindje edhe me shkrimet e tij. (Për Zadejën, mbështetja në muzikën folklorike, ishte shumë ma tepër se 'formë'). Ndërsa për përmbajtjen, tekstin a programin, kur do të kishte, do ta kontrollonin vetë, siç banë me Operen 'Dasma', me temë nga romani me të njëjtin titull i Kadares, që praktikisht e ndaluen që në hapat e para.

Puna për organizimin e një institucioni të ri, si do të ishte Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore, ishte një sipërmarrje e madhe edhe organizative. Sigurisht Zadeja vinte me një përvojë edhe në punët praktike e organizative, por me siguri do të ketë studjue edhe një projekt-platformë që i ishte kërkuar ma parë Ramadan Sokolli, Gaqo Avrazit, Zef Grudës e Koço Uçit.

Puna e Zadejës ishte nën kontrollin e lentes zmadhuese të Vendimeve të Plenumit të XIII të KQ të PPSH, në prillit 1955, mbi *“çeshtjen e folklorit, pasurisë dhe zhvillimit të tij përmes formave të ndryshme”*. Por Çesku kishte jo vetëm përvojën e Ansamblit të Ushtrisë, por e kishte në gene dhe të domosdoshme mbështetjen tek folklor në krijimtari.

Shfaqjet e Ansamblit u banë gjithnjë e ma cilësore dhe publiku i ndoqi në çdo anë të vendit ku shkonte. Sipas kompozitorit T. Harapi: *...për këte ansambël Çesku përpunoi një varg të gjatë këngësh popullore të rrethëve të ndryshme të atdheut. Përpunimet e Zadejës, të bëra me kriter e shije, kanë ngelë modele më të mira të përpunimeve tona në këte fushë. Ti tilla janë ‘Shkon djali termal’, ‘Ta dish, ta dish’, ‘Kur më zbret nga Voskopoja’, ‘Kurvelesh, o zemra ime’ etj.f.204*

Mendime shumë vlerësues pati Ansambli nga kritika, përfshi A. Papariston, por edhe nga kompozitorë të huej.

Në këte përfundim shtohet shumë veprimtaria studimore e publicistike e Zadejës për problemet e zhvillimit të muzikës së kultivuar e mbështetjen në mënyrë krijuese tek folklorit. Vemendje terheq shkrimi ‘Mendime mbi kriterin e përpunimit të këngëve popullore’, ku nuk harron të theksojë *sipas përvojës personale, pra larg shablloneve. Kam bindjen e plotë se formimi i individualitetit krijues artistik kombëtar, në aspektin praktik, fillon që me përpunimin e këngës popullore dhe vazhdon se kjo punë asht një fillesë e domosdoshme për çdo krijues dhe ka lidhje me problemin e novatorizmit dhe të ardhmes së muzikës, duke përfshirë zhvillimin terësor të mjeteve të muzikës brenda sferës shumë më të gjërë të stileve bashkëkohore.f.205* Siç shihet ai, pa mëdyshje, i le shteg e nxitë krijuesit të studjojnë e të shkruajnë një muzikë bashkëkohore.

x x x

Një kapitull të veçantë autori i kushton jetës private të Zadejës, që ajo kohë i la gjurmë e plagë deri sa gjeti limanin me pushue.

### **Zadeja themelues i parimeve të ‘Shkollës kombëtare në muzikë’**

Ndoshta këtu, që asht edhe thelbi, prof. Tole ndalet ma shumë, tue i matë fjalët dhe tue shfrytëzue opinionet ma autoritare e bindëse për këte çeshtje. Bahet fjalë për tendencat e zhvillimit të muzikës kombëtare!

Edhe gjatë studimeve, por sidomos mbas tyne, Zadeja krahas krijimtarisë, herë pas here jepte edhe mendime për zhvillimin e muzikës sonë kombëtare. Kjo lidhje komb-muzikë na kujton atë që kishte shprehë dhe Konica e që autori Tole e citon: *...kombi shqiptar*

*nuk është një komb dhe s' do të jetë një komb gjersa t'i jepet shpirti që i mungon dhe se muzika e vertetë, muzika e madhe që hyn më thellë se cipa është një nga veglat më të forta për të formuar shpirtin e një kombi. F.246*

Tue ndërtue 'koralen' për këte temë, prof. Toke citon edhe prof. E. Koço: *...nacioni i kombëtares, i psikologjisë kombëtare të Zadeja nuk ishte dogma e imponuar nga metoda; ai egzistonte në qenien e tij, në ndërgjegjen e tij; ai besonte te ky nocion sepse i tillë është sfondi i tij kulturor i trashëguar nga qyteti i tij i lindjes dhe shkolla e lartë ku studjoi. f.246*

Vertetë vendi ynë hyni vonë në udhën e krijimit të shkollave nacionale muzikore, siç hynë vendet e Europës, por udha e ndjekun qe e drejtë. Prof. Toke citon edhe kompozitorin T. Harapi, që mendonte se përpjekjet për krijimin e shkollës kombëtare në muzikë kishin filluar që gjatë Rilindjes Kombëtare.

Por vetëm ma vonë, në mënyrë të vetdijshme e shkencore, ky proces shkoi në ngjitje nga ata që patën fatin të ndjekin shkolla jashtë dhe sidomos mbas Luftës në mënyrë ma intensive, të ndërgjegjshme e të shkollueme. Kështu u bashkue kultura perëndimore, ajo përparimtare sëbashku me atë shqiptare.

*Kur flasim për stilin nacional kemi parasysh një bashkim karakteristikash artistike në zhvillimin historik të kulturës muzikore të një populli. f.243* shkruente Zadeja në një nga shkrimet e shumta, ku përcillte zhvillimet e problemet e krijimtarisë muzikore me frymë kombëtare. Ai ishte i bindun për atë, që thonte edhe Kujxhija në vepren e tij: *Çdo muziktar shqiptar po desht me ndertue diçka verte kombtare, duhet ta ngrehin ndertesën e vet mbi themelet e shpirtit të valleve.*<sup>9)</sup>

E utori Toke përmend shkollat kombëtare dhe kompozitorët Glinka, Smetana, Dvorzhak, Schopin etj etj. *Qellimi im krijues, thonte, ka qenë gjithnjë të bëj ç'është e mundur për të ndihmuar, sa do në mënyrë modeste, në krijimin e lartë të stilit kombëtar të muzikës profesionale.* Tek Zadeja u bashkuen kultura përparimtare europiane me kulturën shqiptare.

Në fillim të viteve 1960 Zadeja ishte 34 vjeç dhe tashma kishte formuar qendrimin e tij të konsoliduem për muzikën kombëtare. Ai mendonte se:

*Të shkruesh shqip asht një kerkesë minimale e kjo nuk do të thotë të kalosh në nacionalizëm dhe shtonte:*

*-problemi ynë nuk asht i njillojtë me atë të një populli ku shkollat profesionale janë krijuar disa qindra vjet ma parë, ku folklori ka gjetë një mishnim logjik dhe shumë të avancuem në veprat e kompozitorëve profesionistë.*

*-psikologjia nacionale asht e lidhun dhe me stilin individual të kompozitorit.*

*Nji metodë e tillë s'i ka zvooglue tiparet individuale të këtyne mjeshtrave, (e përmend, Scarlati, Bach, Wagner, Rimski-Korsakov, Shope, Grig, Çajkovski, Shubert, Gershvin e Bartok), përkundrazi i ka perforcue. f.251*

Shumë aktual asht preokupimi i Zadejës tek vepra "Vetparja e procesit", që e shkroi nga fundi i jetës: *Gjithashtu nuk duhet harruar se ndikimi i kulturës orientale bizantine e*

*me vonë sllave, që lidhen me historinë shekullore të popullit tonë e kanë vështirsuar akoma ma tepër procesin e zhvillimit origjinal të kulturës muzikore kombëtare, meqë 'intuita' artistike e kufizuar nuk mundet të përballojë këte 'mbingarkesë' të gjithanshme si në plan estetik, ashtu dhe profesionale në përputhje me kërkesat e kohës.*

Mbas krijimit të veprave të mëdha e dinjitoze si *Sinfonia N. 1* e Zadejës-1956, *Opera Mrika* e P. Jakovës -1958 dhe *Baleti Halili e Hajrija*, Tish Daija- 1963), autori Tole, tue permendë Gjoken, Zadejen, Jakovën, Dainë, Harapin, L. Antonin etj, që u mbështetën mbi trashigiminë njizërëshe folklorike, pra në atë modalo-tonale të Veriut, konstaton se këto vepra *ishin vertetë një arritje për të kapur kohën e humbur*", por përsëri larg krijimit të figurës së kompozitorit kombëtar.[Në fakt në kohën e tretë të Sinfonisë Zadeja shfrytëzon edhe një temë nga Jugut]. Dhe insiston tue thanë se *jemi ende larg ngritjes dhe të pasurit të një shkollë kombëtare në muzikë, si në pikpamje të platformës dhe qartësisë së parimeve krijuese që lidhen me te, gjithpërfshirjes së krijuesve shqiptarë të muzikës që do të merrnin pjesë në këte proces, por edhe numrit relativisht të paktë të veprave muzikore.* E autori i kësaj vepre kaq të gjanë, vazhdon me mendimin se vetëm kur Zadeja kompozoi *Delinën, Koncertin per piano* e *orkester* e *Sonaten për violinë e piano* në vitet 60-70, që, tue perifrashue Çabejn i quen 'Muzika modalo-tonale e Veriut' (apo Qarku muzikor i Shkodrës) dhe ajo 'Pentatonike –atonale e Jugut' (Qarku muzikor i Korçes), dhe kur patëm *edhe pjesmarrjen e kompozitorëve nga trevat e Jugut, kemi krijimin e Shkollës Kombëtare në muzikë.*

Ndër vite, pa dyshim vepra e Zadejës, ashtu si e ndjek ndër vite akademiku Tole, bëhet shumëdimensionale, por gjithnji thellësisht kombëtare.

Ndërkaq terheq vemendjen një letër, e shkrueme me shkrim dore në gegnisht nga Zadeja, drejtue Ramiz Alisë. Në fakt ishte një përgjigje ndaj një kërkesë që Alija i kishte ba Zadejës për thelbin kombëtar në krijimtari. Jemi në vitin 1963 dhe Shqipëria ishte vetizolue nga Traktati i Varshavës. Prishja e marrëdhanive me Partinë Komuniste të BS që tashma ishte ba 'revizioniste', kishte nderpre edhe referimet që deri atëherë kishin qenë shembull për t'u zbatue edhe në fushën e artit në vendin tonë. Miqësia me Kinën dhe forcimi i kultit të individit, shtuen kontrollin e shtërnguen frenin ndaj letërisë e artit në përgjithësi. Opinioni për Zadejën, për krijimtarinë e tij e mbështetun në çdo vepër gjithnji në mënyrë krijuese në muzikën folklorike e banë atë pikë refrimi edhe për sferat e nalta.

Të pakten R. Alija kërkonte të ishte i qartë, sepse shokët e tij shikonin kryesisht biografinë, para se të ndigjonin a lexonin veprat. E. Koço thot në lidhje me këte problem: "*Edhe autoritet shtetërore e partiake, kishin nevojë për 'te'*".

Letra e Zadejës fillon: *Simbas porosisë po ju shkruaj -e mandej vazhdon në gegnisht.*

Por Letra meriton të lexohet, sepse asht një manifest edhe i guximshëm i qendrimit të Zadejës. Tregohet dhe muzikolog, kur i referohet muzikës ma të vjetër të dokumentume, Valleve shkodrane, ku shihet *ma konkrete veçantia nacionanale*, por ai i sheh ato në zhvillim dialektik dhe thotë se *në variantin e mavonshëm kemi për të pa se kanë pasue*

*ndryshime, asht zgjanue cilësia nacionale. Por kur flet për krijimtarinë e re, ai asht kategorik: mjetet shprehëse rinovohen sepse nuk mund të shkruhet 'në alfabetin e vjetër. Citon Çajkovskin e spjeron sepse në muzikë ai ndjehet rus në kuptimin ma të plotë të kësaj fjale. E vazhdon: Sa ma i zhvilluem asht një nacionalitet, aq ma tepër ka në kulturen e tij elemente internacionalë. Spjeron rastin e Glinkës që me visarin e folklorit rus krijoi shkollën nacionale ruse.*

Tue folë për krijimtarinë, Zadeja ndalet tek stili që e sheh edhe ate në djalektiken e zhvillimit të kulturës muzikore të një populli. E merr si model për analizë e vlerësim operan 'Mrika' të P. Jakovës. *Mjetet shprehëse janë të gjithë popujve, por stili e fryma janë kombëtare.* [Përsëri një vlerësim i randësishëm për Jakovën nga ana e tij.]

Përfundon letren tue u angazhue se do të shkruente në shtyp *mbasi kritika nuk egziston fare.*

## **Konservatori e Zadeja**

Më 15 janar 1962, me 'Oden e Gëzimit' të Beethoven, u hap në Tiranë Konservatori me drejtor Albert Papariston, me Çesk Zadejën si profesor i kompozicionit dhe polifonisë e me mjaft pedagogë të tjerë.

Në libër i kushtohet një vemendje e veçantë punës organizative e profesionale-pedagogjike të Zadejës, në klasën e të cilit u përgatit plejada ma cilësore e kompozitorëve të ardhëshëm. Ishte vetë Zadeja që harton programet e katër viteve dhe madje në libër shohim edhe shenime për kerkesat ndaj studentëve dhe detyrat që ata do të kryenin. Por ishin principet e Zadejës edhe në pedagogji që e banë atë të veçantë.

Zadeja ishte i bindun se mbrenda stilit kombëtar mund të krijohet stili individual, si premisë për krijimin e shumë individualiteteve krijuese në muzikën shqiptare. Dhe, si për ta vertetue që Zadeja ja arriti kësaj, autori Tole zgjedh edhe përshtypjet që i kanë dhanë atij studentët e Zadejës. Janë T. Harapi, K. Lara, A. Krajka, H. Dalipi, L. Dizdari. Prof. dr. Sh. Kushta, K. Laro, Prof. Th. Gaqi, E. Shengjergji, A. Peçi, A. Lalo, K. Shkreli, J. Minga, I. Shehu, D. Tukiqi, A. Avrazi, Gj. Nd. Shllaku, A. Gjebrea, A. Hila, M. Kapidani, Çezar Salamanca (Spanjë), T. Dhomi (Kosovë) etj. që krijojnë me përshtypjet e tyre, si me copza pazëlli, figurën komplekse të pedagogut largpamës, të thjeshtë, të aftë; të njeriut që edhe shtëpinë e vet e kthente shpesh në klasë.

Por Zadeja trajtohet kryesisht si kompozitor dhe, si asht e udhës, autori Tole përsëri në mënyrë korale, fillon analizën e veprave madhore të Zadejës, tue fillue me Sinfoninë nr. 1. Asht kritiku A. Paparisto që e quan atë 'Sinfonia e parë shqiptare'. E këtu Tole citon muzikologun Z. Shuteriqi që thotë se Sinfonia e Gjokës (1920) nuk ishte sinfoni, pse asht me dy kohë, edhe pse kohën e parë e zhvillon në formën e Sonatës. E këtu mendimet mund të jenë të ndryshme.

[Në lidhje “me dy kohë” të Simfonisë së Gjokës, dirigjenti Eno Koço shkruen. *Platforma e orkestrimit të plotë ekspozohet plotësisht e qartë nga autori dhe çdo muzikant profesionist i kohës së sotme, i apasionaur mbas Martin Gjokës do mund ta çonte deri në fund këte dëshirë të papeërfunduar të Gjokës. Raste të tilla nuk janë të pakta në historinë e muzikë botërore. Mjafton të përmendim Requimin e Mozartit.<sup>10)</sup>*

Sinfonia nr. 1 e Zadejës, analizohet e vlerësohet me të drejtë si një arritje që na ban nder si komb. Pavarësisht se si temë të dytë të kohës së parë ai shfrytëzon një *Valle shkodrane* (e dyta në librin e Kujxhisë), dhe në kohën e tretë një temë nga jugu, ajo asht vepër thellësisht mbarëkombëtare. Me këte vepër ai ishte duke mbyllur një kohë dhe duke çelur një fazë të re, shkruen i entuziasmuem Tole dhe citon Prof. Dr. F. Hysi që flet edhe për krijimtarinë në përgjithësi të Zadejës: *...këta janë proçese historike, të cilat shkëputen përfundimisht Shqipërinë nga varësia shumëshekullore turko-bizanzine ...Me krijimtarinë e tij ai arriti të prekte po thuej të gjitha format e gjinitë e trashiguara nga muzika europiane dhe ajo shkollave nacionale të shekullit XIX-të dhe të krijonte me to kuadrin shqiptar të një kulture të herëshme me rrënjë kristiane. Të vjen e natyrshme të krenohemi edhe me përkursorët e muzikës së kultivueme shqiptare që, në kondita shumë të vështira, shkruen vepra që ndikuen në krijimin e brezave të rij të cilët e çuen ma përpara muzikën shqiptare në përgjithësi. Këte gja e ban disa herë Tole në vepren e tij.*

Autori Tole pati fatin të merrte intervisten e fundit që ka dhanë Zadeja, atë të vitit 1996, në lidhje me Simfoninë, të shkrueme tashma dyzet vite ma parë, pra në vitin 1956. Asht me shumë interes të lexohet e plotë. Edhe pse tashma i afirmuem, Zadeja asht modest. *Me gjithë se pa një program të detajuar, jam përpjekë që vepres t'i jap një tingllim epiko-lirik, - kemi zgjedhë vetëm këte frazë nga kompozitori i shquem.*

Ndoshta kritiku i njohur Albert Paporisto ka dhanë përkufizimin ma të saktë për Simfoninë, që edhe Tole e citon: *‘Tema kryesor e Simfonisë është tema e atdheut, tema e Shqipërisë. Dhe tue dhanë një përkufizim përmbledhës të krijimtarisë së Zadejës, kritiku thot: Që në fillimet krijuese mendimi mbi figuren madhore të atdheut do të terheqë vemendjen dhe interesin e vazhdueshëm të tij.*

Studjuesi, Prof. Eno Koço, shprehet për Simfoninë e Zadejës: *“Shfrytëzimi i motiveveve të Valleve shkodrane ‘Buloi mali xhanxhafil’ dhe ‘Mori drandofillja e bardhë’ si laitmotive të temës së parë dhe të dytë të Kohës së Parë. Në kohën e dytë ndjehet se është krijuar në frymën e motiveve epike rapsodike të Shqipërisë së Veriut. Koha e tretë, një skerzo e shkurtë, mbeshtetet në motivin e këngës popullore polifonike-pentationike “Ishin dy kunata”. Koha e IV ndërtuar në principin kryesisht të sonatës.*

‘ZADEJA DHE JAKOVA’-nji nëntitull i arsyetuem, por edhe i tensionuem.

Siç e kemi trajtue edhe ma parë, ka qenë gjithnji Çesk Zadeja ai që e ka vlerësue veprën e Jakovës dhe nuk ka pasë asnji arsye që ta ulte atë. Zadeja e ka quejtë Jakovën *mjeshtër e mësuesin* e tij.

Kujtojmë që këte opinion pozitiv ja ka shprehë dhe sferave të nalta. Zadeja e çmoi gjithë kohën randësinë e operas 'Mrika' për muzikën shqiptare, si në dokumente publike ashtu dhe në letra konfidenciale, si ajo që i dergon R. Alisë në vitin 1963. Aty me plot gojën ai pohonte se për shembull *në qoftë se marrim operen e Jakovës 'Mrika' ne kemi me pa se ajo qendron në stilin nacional dhe ne këte e shofim nga melodika, karakteri në përgjithësi i armonisë, faktura* etj.f.318

Me 17 janar të vitit 1968, me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar, u shfaq në Teatrin e Operas dhe Baletit opera 'Gjergj Kastrioti-Skenderbeu' e kompozitorit Prenkë Jakova, me libret të Lllazar Soliqit. Mbas pak në gazetën 'Zëri i Popullit' doli një artikull kritik me titullin 'Mbi operan 'Skenderbeu'', shkruar nga Çesk Zadeja dhe Dritëro Agolli, ku kompozitori dhe libretisti këshilloheshin të ulëshin edhe një herë për ta parë...

Në lidhje me atmosferën e asaj kohe, kur po imitonim Revolucionin kinez, Eno Koço shprehet se për operën e Prenkës, që në përgatitjen e saj, ishte nderhy pa kriter, për ta shkurtuar dhe ishte vepruar si në *Kinë asokohe që gjykimi i veprave të reja muzikore ishte normë kolektive, të gjithë mund të jepnin mendime, mund të bënin vërejtje bazuar në zërin e masave. Kështu që edhe opera e Prenkës nuk kishte t'i shmangej këtij gjykimi kolektiv apo specialistësh të fushave edhe jasht muzikore. Me të drejtë muzikologu S. Kalemi thotë se këto ndryshime përjashtuen arie, ansamble, skena e deri tablo të tëra; spostuan vend e pa vend shumë pjesë të operas*.f.320

Prof. Tole mendon se Zadeja e Agolli tue shkruar artikullin *këte ata e bënë më së shumti nga pozita mbështetëse, e jo nga e kundërta e tyre...*dhe citon shkrimin ku thuhet se *opera me temë nga historia është një gjini e vështirë. Të metat që vëmë re, pikrisht, kanë lindur nga kjo vështirësi*.f.320

[Ndoshta muzikologu S. Kalemi dhe shkruesi i këti artikulli, për shkak të moshës dhe lidhjeve që kishim, mund të japim edhe atmosferën e asaj kohe dhe çfarë thuhej në ato mbledhje ku diskutohej se si duhet të ishte opera, edhe ajo ishte kompozue. Kalemi, për shkak të konfidencës me kompozitorin T. Harapi dhe unë për konfidencën me Ndoc Shllakun, kushrinin dhe shokun e ngushtë të Prenkës, që shfrehej sa herë që vinte nga Tirana; por dhe me Albert Pappariston kur e 'qarkulluen' në Shkodër.

Kam pasë fatin të asistoj në proven e përgjithëshme të operas, që nuk ishte gja e lehtë edhe për probleme të sigurisë së sallës, mbasi të nesërmen do të jepej premiera, ku do të vinin autoritetet dhe të ftuem nga e gjithë bota. Ishte edhe UNESCO që e kishte shënue këte datë si të sajën. Prova pati një pritje entuziaste: 17 minuta duertrokitje!

Atë ditë Mehmet Shehu, mbajti një fjalim në sesionin kushtue 500 vjetorit të heroit tonë, ku ishin të pranishëm edhe të gjithë delegacionet e hueja, ndër ta, ma shumë studjues. Ajo

që mbaj mend nga leximi i atij fjalimi, asht përshtypja që më la. M. Shehu e cilësoi Skenderbeun, vetëm pak ma shumë se një kryefeudal. Ishin fshi të gjitha vlerësimet që bota perëndimore në qinda e qinda vepra të shkrueme mbas vdekjes së tij i kishin dedikue heroit. Ishte fshi bashkë me operen e Vivaldit etj. edhe thania e famshme e Volterit për ramjen e Kostantinopojës. Ishte koha që në Shqipëri duhet të kishte vetëm një hero, e ai duhet të ishte vetëm Enver Hoxha. Salla e mbushun me 'të ftuem me protokoll', shumica e të cilëve shihnin për herë të parë opera në jetën e tyre, të lodhun nga mbledhjet, ma shumë shikonte nga llozha qendrore, se sa ndigjonte. Dhe shkoi, si shkoi.

Dhe tashti, që ka kalue ma shumë se gjysëm shekulli, e mund të gjykojmë me mendje të ftohtë, shtrojmë dhe pyetjen: Nëse Zadejës i ishte 'propozue nga nalt' të shkruente, a kishte njeri në atë kohë që do të guxonte me refuzue? (Mos të harrojmë se jemi gati një vit mbas fjalimit të '6 shkurtit' që në fakt u tha shqiptarëve 'nuk keni zot', tue i dhanë me kuptue se ishte ai e vetëm ai që 'kthjellë e vranë').

Tue e ndjekë këte çështje, autori Tole na ban me dijtë se disa muej pas premjerës, në diskutimet e mbajtura në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, Zadeja me shumë përkushtim përgatiti një material studimor të plotë, me rreth 43 faqe në dorëshkrim, me analiza e vezhgime mbi veprën, në krye të të cilave ai pohonte se...*suksesi i operas 'Gjergj Kastrioti-Skenderbeu' simbas libretit të Llazar Sliqit, me muzikën e Prenkë Jakovës, qëndron në radhë të parë në guximin e në këmbënguljen e autorëve për të na dhanë një vepër të madhe skenike mbi heroin tonë kombëtar, mbi traditat e mëdha luftarake të popullit tonë...një subjekt i tillë justifikon plotësisht punën dhe vullnetin shembullor të autorëve të operas mbi heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti'. Diskutimi për operen në Lidhje...krahas vërejtjeve vuri në dukje edhe vlerat e veprës së Jakovës.f.322*

Në vitin 1987 në gazetën 'Drita' Zadeja do të shkruente: *'Artisti i Popullit', kompozitori Prenkë Jakova ka realizuar një përvojë të re me vlera për kulturën tonë muzikore shqiptare. Këngët, romancat, përpunimi i këngëve popullore e partizane, të dy operat e tij i përcjellin historisë së muzikës sonë vlera të shquara e gjithnjë aktuale.*

Autori Tole përfundon këte nënkapitull kështu: *Zadeja i qëndroi deri në fund në krah mësuesit, kolegut dhe mikut të tij Prenkë Jakova, me të cilin ishte i lidhur edhe përmes krushqisë. f.323*

## **Kohë të vështira**

'Problemet' që kishim kalue kompozitorët sovjetikë dikur, po trasferoheshin edhe tek ne. Ndërrimi i programeve shkollore, me futjen e punës prodhuese, përgatitjen ushtarake e 'forcimin e boshtit ideologjik të shkollës'; Festivali i XI me Plenumin që pasoi e 'spastrimet' me qarkullimin e kuadrove, krijuen jo pak vëshirësi - për të përdorë një eufomizëm - në jetën artistike të vendit tonë.



Zadeja vazhdonte të punonte dhe të replikonte: *"Nuk jam unë që nuk lejoj ose lejoj të pranohet një veper. Kam vetëm të drejtën e fjalës"*.

Në atë kohë, në një material të KQ flitej për përpjekje të kompozitorëve për të thye kornizat e vjetra të formave klasike.

Grupe, jo edhe aq të pashpalluna, shfaqen edhe në muzikë. Flitej se të parim e kryesonte Çesku. Në libër flitet edhe për diçka, që ndër ne, në rrethe, nuk asht ndigjue, por Tole e ngre: *Perdorimi i muzikës së jugut si laitmotive etj. u prit me skepçizicëm o me qendrime perjashtuese.* f.332

Kompozitori i njohun L. Dizdari e sheh pozitiv këte diskutim: *"Pati një vershim veprash muzikore ku ndjehesh shumë qartë obligimet për vepra me vlera të larta artistike, me karakter të theksuem kombëtar dhe me një gjuhë mjete shprehëse të avancuar dhe bashkëkohore.*

Ka dhe një nënkapitull tjetër me randësi që trajton autori Tole: ZADEJA DHE IBRAHIMI, ku materiali asht shumë i ngjeshun, sepse libri i asht kushtue Zadejës. Ne po citojmë disa kuint-esenca të opinionit mbi këte figurë të re premtuese që po shfaqej në muzikën shqiptare.

Zadeja ishte i pari që përshëndeti pozitivisht arritjet e Feim Ibrahimit, me një herë pas premjerës të Koncerti n. 1 për piano e orkestër në vitin 1971. Duke folur për elementët e reja të përdorura në krijimtarinë më të fundit shqiptare, të cilat sipas tij ja kanë arritur qellimit për pasurimin e muzikës sonë, thotë: *...Kjo shprehet në dinamikën shumë efikase dhe tek principi i përpunimit të karaktereve të koncertit të Feim Ibrahimit.* f.328

Vazhdon Tole: Ky ishte fakt. *Muzika e Ibrahimit erdhi dhe u ba ma dinamike, e drejt për drejtë, gjë që solli një rivoterësim të ritmit si parametër i barabartë me melodinë dhe jo më poshtë saj nga randësia. E mbështetur në tërësi mbi bërthamë motivoesh të shkurtëra, gjuha muzikore e këtyre veprave u krijua si një përbashkim mes tipareve pentatonike të melodisë, harmnonisë që natyrshëm nuk e parakuptonte tonalitetin, por që prirej drejt polimodalitetit dhe në disa raste sillte atonalen në rrugë shqiptare në muzikën tonë, krahas formave të reja të trajtimit të polifonisë me iso, përfundon Tole.* f.329

Citohet dhe Zadeja që Ibrahimin e cilëson, *si kompozitori i parë që mbaroi terësisht studimet brenda vendit, por edhe si kompozitorin që përfaqëson në një farë mënyre një kapecyell epokash, 'kjo e ngjashme me një urë që lidhte dy brigje', shton Tole.*

## **Veprat ndër vite**

Në librin e prof. Toles gjejmë të emërtueme të gjitha veprat e Zadejës dhe kohën kur u krijuan; por zgjedh një mënyrë, sipas mendimit tonë të drejtë, tue i shenue ato herë pas here mbas një grupi vitesh e tue u ndalë, për analizë, tek vepra ma madhore e asaj përfudhe.

Kështu fillon me perjudhën 1957-1964, e mbushun me krijimtari të dendun, por të formave 'të vogla' o relativisht të tilla, në pritje të një akumulimi që kulmoi me baletin 'Delina', që u shfaq mbas baletit 'Halili e Hajrija' të Tish Daisë. [Nuk asht çudi që këte precedencë, pavarësisht nga përrjudha e krijimit, vetë Zadeja ja dha shokut të tij të ngushtë të rrugicës, të shkollës dhe të studimeve. E kështu: Ç. Zadeja-Sinfoninë e parë, P. Jakova-operan e parë, T. Daija -Baletin e parë].

Këte herë, thotë kompozitori e kritiku T. Harapi, *Zadeja me 'Delinën' tregoi se Baleti ishte fryt i një pune serjoze profesionale...mbas një shfletimi të letërsisë së njohun botnore e klasike moderne..*, ndersa Tole shton se me këte vepër Zadeja në mënyrë të ndërgjegjëshme zbuloi laboratorin kompozicional popullor mbarëshqiptar, plazmoi me dashje në muzikën e tij... gjithë lëndën muzikore (e cituar drejtpërsëdrejti ose jo nga folklori verior dhe ai jugor).

Baleti 'Delina' tërhoqi vemendjen e mendimit kritik muzikor shqiptar që u shpreh me larmi mendimesh e analizash nga shumë autorë.

Tole e sheh të arsyeshme të tregojë gjatë, në katër faqe, subjektin e vepres, sipas libretit, që asht mbështetë në legjendën e krahinës së Matit rreth 'Gurit të Vashës'. E ban mirë, sidomos për brezin e ri, që nuk ka pasë rastin ta shohë.

Në Perjudhën 1965 deri në vitin 1969 deri tek opera 'Dasma' e papërfunduar, Zadeja krijon ma shumë se 70 vepra, ku vertetë shumica janë kangë, por mes tyre gjejmë dhe *Koncertin për piano e orkestër, muzikë instrumentale, muzikë filmi, kuadro simfonike etj.*

Gjatë gjithë jetës Zadeja nuk shkroi opera. 'Dasma', si roman, konsiderohej herë si vepra ma e keqe e Kadaresë, herë si 'nji vepër e guximshme kundër rregjimit'. Në një dokument të KQ të Partisë, Tole gjen këte shenim: "[Zadeja] 'le të vazhdojë kompozimin pse ka kohë që ka filluar punën'. Futet në mes 25 vjetori që kërkonte një vepër ma të politizueme. R. Alija shkruen: 'Mendoj se duhet pezulluar puna për këte opera'. M. Myftiu të ban edhe me qeshë: 'Unë, të jem kompozitor, nuk i futëm operas me këte libret'. Mbeti, nga kjo tentativë, vetëm Aria e Katerinës dhe Monologu i plakut. Lufta e klasave, ideologjia...

Gjatë viteve 1970 - 1982 rezultojnë që Zadeja ka kompozue 210 vepra . Ka mjaft kangë, por gjejmë edhe *skica simfonike, albume për piano, përpunime e muzikë instrumentale*, por edhe Baletin 'Shqiponjat sypatrembuna', *muzikë simfonike si Suita n 1, n. 2 e n 3.* dhe 'Valle socialiste'(30 vj i Çlirimit). Të kësaj përrjudhe janë dhe *Sonata për violinë e piano, muzikë skenike* [ndoshta bahet fjalë për skena baleti]; janë edhe shumë pjesë që i quen *vokale simfonike*. E vijmë deri tek baleti 'Para stuhisë', shfaqë me 20.5.1982.

Edhe për këte vepër, që me të drejtë autori Tole e vendos ndër veprat ma të mira të Zadejës, ndiqet po ajo metodë, që mund ta quejmë edhe pedagogjike, sepse asht edhe orientuese për kompozitorët e rij dhe njikohësisht për spektatorin. Spjegon gjanësisht libretin e baletit që ka për bazë romanin e njohun të Jakov Xoxe 'Lumi i vdekur', që 'nuk duket se është shkruar nën trysninë e realizmit socialist'. Personazhet e veprës janë kryesisht kosovarë të trasferuem nga Zogu në kënetat e Myzeqesë që vuejnë shfrytëzimin

e feudalve dhe veglave të tyne. Ky fakt dhe vetë tema, sipas Toles, *i dha mundësi Zadejës të konsolidojë “gjuhën e tij muzikore kombëtare duke ndërthurur ...elementët muzikorë të Veriut me ato shumëzërëshe të Jugut...si kompozitor mbarëkombëtar që ushqej nga njëzërshi i Veriut të Shqipërisë me shumëzërëshin e polifonisë me iso të Shqipërisë së Jugut.* f.484 [Me gjithë këte pasuni të dhanash për baletin, si edhe për veprat e tjera të mëdha, shumë mirë mësuesit e muzikës, me anë të rregjistrimeve, mund të zhvillojnë orë ndigjimesh muzikore për të kultivue ndër nxanës dashuninë për muzikën klasike. Gjithnji me shpresë se do t'i jepet ora e dytë landës së muzikës, që i asht heqë pa asnji konsultim. R.P.]

Publiku e kritika e priti shumë mirë baletin. (Ishte edhe koha kur një vit ma parë, në vitin 1981, ndodhen demonstrat shqiptare kundër shovinizmit serb). Ndoshta kuintesenca e kritikës shqiptare për këte vepër asht ajo që ka zgjedhë Tole, atë të kompozitorit Shpetim Kushta: *Partitura e baletit ‘Para stuhisë’, ka dhjetra faqe të cilat për nga thellësia psikologjike dhe sidomos për nga ai kontrapunt ideshë muzikore, realizuar përmes një filtri të gjatë teknikash kompozicionale, mbeten si pika kulmore të opusit të tij , por edhe si pika kulmore të vetë simfonizmit shqiptar.*<sup>11)</sup>

Nga viti 1983 deri ne vitin 1989 kemi nga Zadeja edhe 150 vepra të tjera të gjinive të ndryshme: *muzikë skenike, suita, albume per piano, pjesë instrumentale, muzikë vokale sinmfonike, kuadro simfonike, Suita simfonike n. 4, Rapsodi për orkestër etj etj.*

Si për baletet ‘Vajzat e qytetit të gurtë’ 1989 dhe ‘Milosao’ 1990, që nuk u vue në skenë, autori Tole ndjek po atë pedagogji, pra udhëheq lexuesin në përmbajtjen e veprës dhe analizën muzikore, në rastin e fundit ma të reduktuem.

Për baletin “Vajzat e qytetit të gutë” prof. Tole shprehet: *Në faqet muzikore të baletit gjejmë një Zadejë të ripërtrirë nga kontakti dhe thellësia e komumikimit të laboratorit të tij krijues me larminë e muzikës iso-polifonike të Jugut, e cila duke qenë shumështrësore ndikoi tek Zadeja për një rikonceptim të gjuhës së tij muzikore polifonike si asnji herë ma parë.* f.509-510

## **Zadeja i përfolur i përgjuar**

**(1969,1972,1974, 1975, 1977,1978, 1984)**

*Janë të çuditshme dhe shpesh diabolike marrëdhëniet e diktaturave me artistët e mëdhej, si Zadeja, thot Tole. E pa dashtë mendja na shkon prap tek vepra e Solomon Volkov-it ‘Stalin e Shostakoviç’...*

Ishte hapë për Zadejën dosja e tipit PP (përpunim paraprak) dhe nëse justifikohet se duhej vazhdue, gja edhe që ndodhi, u hap dosja 2B me të cilen do të ndiqej Zadeja.

Çudi, por e vertetë, Zadeja, ‘Artisti i merituar’ i vitit 1970, ‘Artisti i Popullit’ më 1975, bahet dhe ‘Artist i përgjuar’ edhe pse kishte marrë ‘Urdhërin e Punës të kl.të I-rë’ që më 1954 për muzikën e filmit ‘Skenderbeu’, ‘Urdhërin ‘Naim Frashëri’ të kl.I-rë’ në fushën e kritikës dhe Çmimin e Repiblikës së shk. II-të.

Sidomos mbas martesës me Alma Radovicka, për shkak të biografisë së saj, Zadeja përflitej sistematikisht prej shtetit e organeve të sigurimit. Megjithëkete, R. Alia i ka dalë në disa raste në krah dhe ka amortizuar goditjet politike ndaj Zadejës, ve re autori Tole dhe këte edhe e dëshmon në libër. f. 638

Në një mbledhje të Sekretariatit të KQ të Patisë ku mungon E. Hoxha, zhvillohet kjo bisedë:

-M. Myftiu: *Mendoj se nuk shkon emërtimi i Çesk Zadejës si drejtor i Drejtorisë së Muzikës e Koreografisë në Komitetin e Kulturës dhe Arteve... e shton duke u nisur nga biografia e tij.*

-R. Alija: *Ne biografinë e tij e dijmë. Ai ka 30 vjet që po punon.*

-M. Myftiu : *Grueja tij, Alma, ka qenë bija e një agjenti, eksponent i Fultz-it, kështu nuk është Çesku për drejtor. Jeton apo jo babai i saj, unë nuk e di; por kjo vetë është e bija e tij.*

-R. Alija: *....e lëmë të rrijë aty ku është, por s'ka njeri tjetër për ta venë drejtor në këte sektor. f.642*

Kur më 1975 në Mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor për dhanien e titullit Artist i Popullit, për Zadejën ka vërejtje:

-Spiro Moisiu: *Zadeja në fillim ka qenë armik, por u martua me kunaten e Tuk Jakovës edhe kaloi këtej.*

-Telo Mezini: *Tani e kemi kompozitorin më të mirë.*

-H. Lleshi. *Tani gjykojmë në këto rethana . (Dhe i jepet titulli). f.647*

Në Dokumentin e Ministrisë së Punëve Brendëshme, 'Mbi kontingjentet në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë' të dt. 19.4.1975', biografia e Çesku asht zi a ma zi. f.651

"Në rregjimin e Zogut e okupacionit si familje kanë qenë pro këtyre rregjimeve, por Çesku nuk ka pasë aktivitet. Ky vetë ka krye shkollën e françeskanëve në Shkodër dhe me përkrahjen e klerit është dërguar për studime në Itali (Romë) 1941-1943. Me ardhjen e fashizmit janë lidhur me te. Ka kushri të tij të III-të Dom Ndre Zadenë, i pushkatuar. Edhe mbas çlirimit familja e tij nuk kanë mbajtur qendrim të mirë. Çesku ka kryer studimet në B.Sovjetik. .... f.651

1977: Mbi disa shprehje e mendime armiqësore....(dok i M. P B, 26.12.77,drejtuar Komitetit të Partisë së rrethit Tiranë). *Ka disa individë...,shprehin pikpamje jo të drejta dhe koncepte jo të shëndosha. Mes tyne asht dhe Çesk Zadeja i cila paska thanë lidhur me qarkullimin: Ç'janë këta gjëra që po bëhen, nuk e marr vesh, po na heqin edhe specialistët që i kemi të paktë.*

1978, dosja e tipi 2B pasurohet nga agentja 'Burimi', si për kontrollin punëtor që Çesku qenka tallë tue thanës se *jena rrëfye si tek prifti dhe me 'Lumin e Verdhë' një pjesë pianistike kineze që në atë kohë na kishte ardhë në maje të hundës dhe Çesku paska thanë: Na u ba Lumi me u zveshë e me u la në te. 'Burimi' pershkruen Çeskun: është hipokrit në kuptimin që ndryshe flet në ambjente të mbyllura dhe ndryshe në publik, ku flet fjalë të mira...Si tip ai njihet i dashur, qejfe paprishur, i butë, fjalë të ëmbla, kavaljer, ai quhet në rrethin artistik Dom Çesku (si prifti jezuit). Tek shenimi 'Detyra', thuhet....bashkëpunatori u porosit nga ana e jonë, që shumë gjëra herën tjetër të na i saktësojë më mirë....*

Në vitin 1984 përmenden edhe 10 kaseta manjetofoni që ballerinat paskan fshehë gjatë kthimit nga një turne jashtë shtetit, ku kishte qenë dhe Zadeja, që detyrohet të firmosë.

Autori Tole na tregon se kanë qenë të përgjuem edhe një numër i konsiderueshëm artistësh, tue fillue nga Albert Paparisto, Tonin Harapi, deri tek Odise Paskali. Me

konsekuencën që e karakterizon 'ankohet' se deri më sot nuk ka mundur të gjejë dosjen N. 5356 të Zadejës ku do të bëhej akoma më e qartë për të gjithë, si fazat e ndjekjes, ashtu dhe natyra dhe thellësia e përgjimit të Zadejës. f.654

Mes faqeve kaq impenjative, edhe kur flet për përgjimet, autori Tole gjen mënyrën edhe me e lehtësue me ndonji episod humori, siç ishte edhe natyra e Zadejës.

Si të gjithë njerëzit në atë kohë, edhe Zadeja përpiquej të fliste pa u komprometue. Por edhe donte ta thonte të veten, kur pyetej; edhe pse nën za. Vëlleznit kosovarë, nganjisherë na vinin në pozitë të vështirë, sepse nga naiviteti, apo mosnjohja e realitetit ku vinin, banin edhe pyetje që ishte vështirë t'i përgjigjeshe. Kështu ndodhi në vitin 1972 me akademikun kosovar R. Dhomi, që mbasi nuk po kuptonte - sepse nuk po e ndigjonte atë që po i tonte Çesku - tha: *A ka mundësi me ma përkthye?*

Në lidhje me Kosovën. Shumë kompozitorë kosovarë vizituen Shqipninë, pak shkuem nga Shqipëria me ja kthye vizitën. Zadeja që, sipas V. Tole-s, e quente Kosovën 'Shqipninë përtej Drinit', shkroi shumë vepra kushtue Kosovës dhe me motive kosovare. Si Zadeja, por edhe të tjerë, si F. Ibrahim, e konsideronin një të vetme muzikën shqiptare, si atë që kompozohet në Kosovë si atë që kompozohet në Shqipëri.f.554.

Autori Tole citon Zadejën që në vitet 80' i thotë kompozitorit kosovar Fahri Beqiri: *Mos e konsideroni veten si kompozitorë provincialë. Prishtina dhe Kosova kanë tipate europiane e po ashtu edhe muzika që kompozohet aty. E në fakt kishte të drejtë sepse disa kompozitorë kosovarë ishin shkolluar në Zagreb, Beograd ose në Europë.*

Për këtë lidhje të veçantë shpirtnore me Kosovën, në vitin 1996, për meritat e veçanta të Zadejës në muzikë, e posaçrisht në lidhje me Kosovën, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, e pranoi atë si 'Antar të jashtëm'. Për këtë vlerësim Zadeja është shprehur. *Pa dyshim ky është një nder e vlerësim i jashtëzakonshëm....Sigurisht që obligimi i parë nga fusha e miuzikës nuk erdhi me këtë vlerësim i cili padyshim shumëfishon detyrimet e mia ndaj kulturës e artit mbarëkombëtar. Shumë vite më parë në veprimtarinë time krijues e pedagogjike kam shkruar disa vepra kushtuar Kosovës që, ashtu siç e ka vlerësuar poeti i talentuar Ali Podrinja, 'mbetët flakë e herëshme e ashtit tim'.f.548*

Asht shumë e pasun, ndoshta ma e panjohuna, krijimtaria e Zadejës që ka për temë Kosovën. Por edhe këte herë, autori Toli ja ka dalë e ka muejtë me i gjetë e me i emërtue.

Nga faqja 659 deri në faqen 677 autori boton foto të zvoglueme të titujve shkencorë dhe artistikë e çertifikata për meritat e Zadejës. Janë 30 të tilla.

x x x

Çesk Zadeja dhe Vepra e tij na erdh me këte cilësi e përmasa, falë talentit të tij të rallë, por edhe sepse ai dijtë të mbijetojë në trysninë e kohës, të përballojë luftën e klasave, jo vetëm në saj të veprës e punës së tij të pazëvendueshëm si pedagog, kompozitor e kritik, por edhe për zgjuetësinë e tij të pazakontë, tue ruejtë të pastër figurën e vet morale. Erdh

gati e tana edhe për faktin që ai lavroi ma shumë gjinitë simfonike, instrumentale dhe baletin.

Se si do të kishte krijuar Zadeja në një vend të lirë, askush s'e di, por akademiku Tole, zgjedh nga shumë e shumë mendime, si ban gjithnji, një mendim që na jep pak a shumë përgjigje, atë të shokut të tij, Prof.dr. E. Koços:

*Zadeja i përjdhës së fundit krijuese, i viteve 1990, veçanërisht në 'Tre skicat për orkestër', është ai i një çlirimi ndjenjash i një poetizimi e shakaje që i buron nga shpirti, i një gjuhe muzikore të kthjelltë elokuate e me një sens të përkryer mase në frazimin dhe mënyrën e ligjërit. Sikur donte të thoshte 'Perendi, më jep edhe pak kohë të se tani mund të shçprehem lirisht, hapur, tani mund ta them fjalën time të plotë'. Duket se mosha dhe ndryshimet politike nuk e kishin fenuar energjithë e tij krijuese. Në vitin 1995, për veprën e tij 'Meditim' për v.cello e piano të paraqitur dhe të interpretuar në 'Festivalin e muzikës së re shqiptare' të vitit 1995, u nderua nga Juria ndërkombëtare me çmimin e dytë.f.606*

x x x

Pa kaluar mui i botimit të vepres për Zadejën, akademiku, Prof.dr.V.S.Tole, tashma si person privat, në rrjetin social e kujton kështu profesor Çesk Zadejën në 25 përvjetorin e kalimit të tij në amshim:

*Me 15 gusht 1997 pushoi së rrahu në Romë, zemra e Prof. Çesk Zadejës, kompozitorit i cili ia doli ta shëndrrojë kompozimin e muzikës nga një proces individual, në një akt madhor të dashurisë së Tij për familjen, atdheun dhe për popullin. Lindi në Shkodër, me 8 qershor 1927, në datën që njihet si 'Dita e Oqeanëve' dhe 'fjeti' me 15 gusht 1997, në të njëjten ditë me Shën Mërinë.*

.....

- 1)Prof.dr.Tole, Vasil S.: Çesk Zadeja në muzikën shqiptare-Jeta dhe vepra-Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, 2022- 724 f. ISBN 978-9951-26-053-
- 2)Tole V. 'Muzika dhe letersia' f. 52, Onufri - 1997.
- 3)Zadeja, Tonin. Jeta kulturore e Shkodrës( mesi i shek. XIX-mesi i shek XX), Tiranë, 2006.
- 4)Zadeja Çesk: Nga kanga tek opera, Gazeta Drita, 30 prill 1978. F. 12.
- 5)Prof.dr. Koço Eno. Shih At Martin Gjoka-24 Pjesë e artikuj mbi veprën e tij, përgatitë nga Prennushi Robert, Botime Françeskane, Shkodër, 2010, f.6
- 6)At Pëllumbin Zef: Françeskanët e mëdhej, Shkodër 2017, f. 94
- 7)Histori e muzikës shqiptare, Tiranë , 1963 f. 242
- 8)At Prennushi Vinçenc, Kangë popullore gegnishte, Sarajevë, 1911;Taipi Kasem. Zana Popullore, Tiranë, 1933;Kujxhija K Gjon, Valle Kombëtare, Vol I-rë, Dasëm shkodane, Firenze, 1943.

9)Vepër e citueme, Kujxhija K Gjon, Valle Kombëtare, Vol I-rë, Dasëm shkodrane, Parathanje (IX)Firenze, 1943.

10)Vepër e citueme. Shih At Martin Gjoka-24 pjesë...

11)Kushta, Shpetim, Kujtime dhe impresione me epikun e shquar të muzikës shqiptare, Gazeta 'Drita', datë 24 gusht 1997. f. 8